



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:122922

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05516863

AC.nr.2757/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Arsim Hamzaj, antarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve E. N. M. etj, të gjithë nga Prishtina, të cilët me autorizim i përfaqëson avokat V. H. nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës-ATK me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të shujtave dhe shpërblimit jubilar, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, avokat Valon Hasani nga Prishtina, kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me numër C.nr.3402/21, të datës 04.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt **26.03.2024**, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET SI E BAZUAR ankesa e paditësve E.N. etj, të gjithë nga Prishtina, ushtruar përmes të autorizuarit të tyre, avokat V. H. nga Prishtina, ashtu që: **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me numër C.nr.3402/21, i datës 04.04.2022, dhe çështja i kthehet në **ri vendosje** gjykatës së shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar C.nr. 5063/23, dt: 18.09.2023, ashtë seancës, ka vendosur si në vijim:

- I. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, shpallet **JOKOMPETENTE** në pikëpamje lëndore për të vendosur në çështjen juridike kontesitore sipas padisë së paditësve.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij Aktvendimi, shkresat e kësaj lënde t'i dërgohen Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me çështjen.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor, ankesë kanë ushtruar paditësit përmes të autorizuarit të tyre, avokat Valon Hasani nga Prishtina, për shkak të për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim për gjykatën e shkallës së

shkallës së dytë që të anulohet aktvendimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në ri vendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk është ushtruar nga e paditura.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të ankesës, provave në shkresat e lëndës, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (d) të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësve, E. N. etj, të gjithë nga P., ushtruar përmes të autorizuarit të tyre, avokat Valon Hasani nga Prishtina, rezulton e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësit kanë ushtruar padi kundër të paditurës për shkak të kompensimit të shujtave dhe shpërblimit jubilar, duke kërkuar nga gjykata që ta aprovoj padinë e paditësve dhe detyroj të paditurën në kompensimin e shujtave dhe shpërblimit jubilar në lartësinë e kërkuar nga paditësit.

Gjykata e shkallës së parë, pas bashkimit të padive të paditësve, shqyrtimit paraprak të padisë dhe shqyrtimit të kompetencës lëndore, jashtë seancës, nxjerr aktvendimin e ankimuar me të cilin shpallet in kompetent në pikëpamje lëndore për trajtimin e kësaj çështje juridike, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, përcaktohet që lënda do ti dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative në Prishtinë.

Në arsyetimin e saj lidhur me mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në rastin konkret meqë paditësit janë zyrtar të ATK-së, dhe hyjnë në kategorinë e shërbyesve civil, atëherë kompetent për shqyrtimin e padisë së tyre është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, dhe mbi bazën e nenit 17, 19 dhe 392, pika b) të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe se aktvendimi i atakuar edhe pse nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) në lidhje me nenin 194 të LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, megjithatë i njëjti aktvendim duke iu referuar përmbajtjes së ankesës së parashtresit të saj lidhur me shkeljet e gjykatës së shkallës së parë për in kompetencën lëndore gjen se në rastin konkret zbatimi i gabuar i të drejtës materiale i pretenduar nga pala ankuese në përmbajtjen e saj lidhet më pretendimet shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore lidhur me in kompetencën lëndore të gjykatës së shkallës së parë, e që në rastin konkret i referohen nenit 182 par.1, pika a), në lidhje me nenin 17 par.1 dhe 2, nenin 19 të LPK-së, dhe si i tillë anulohet.

Gjykata e Apelit, nga ekzaminimi i aktvendimit të goditur me ankesë, gjen se gjykata e shkallës së parë shpalljen e saj in kompetentë në pikëpamje lëndore e bazon në faktin se paditësit si zyrtar të ATK-së, hyjnë në kategorinë e shërbyesve civil, dhe mbi këtë bazë, konsideron se në bazë të nenit dhe të njëjtin e trajton si akt administrativ me karakter të përgjithshëm, duke iu referuar nenit 13 par.1 dhe 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, konsideron se kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata e Apelit, i rezultojnë të bazuara pretendimet ankimore të parashtresit të ankesës, së gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të kompetencës lëndore, gabimisht ka vendosur se e njëjta nuk ka kompetencë lëndore në këtë çështje juridike, dhe këtë përfundim të gjykatës së shkallës së parë, tani për tani nuk mund ta pranoj gjykata e shkallës së dytë, për faktin se edhe pse paditësit kategorizohen si shërbyes civil sipas nenit 12 par.1, nënpar.1.1 (shërbyes civil të

karrierës), lidhur me nenin 23 par.1, nënpar.1.3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikë së Kosovës, nr. 03/L-149 (që ishte në fuqi në kohën e ushtrimit të padisë dhe raportit juridik-Kontratës së Përgjithshme Kolektive mbi bazën e së cilës paditësit i bazojnë kërkesat e tyre), paditësit edhe pse janë shërbyes civil të karrierës dhe të nivelit profesional, megjithatë, të drejtat e kërkuara në padi sa i përket shujtave dhe shpërblimit jubilar, nuk prekin në statusin e shërbyesit civil, e që me cenimin eventual të statusit të tyre, të njëjtit do duhej ti drejtoheshin Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, dhe pas rezultatit nga ky organ pastaj ti drejtohen Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, dhe në rastin konkret nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet se e paditura lidhur me kërkesat e paditësve ka nxjerr ndonjë akt administrativ i cili do ti nënshtrohej shqyrtimit dhe rishikimit fillimisht nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës e pastaj edhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, prandaj, në rastin konkret në mungesë të aktit administrativ të nxjerr nga e paditura, gjykata e shkallës së dytë konsideron se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative nuk ka objekt të shqyrtimit të padisë së paditësve sipas nenit 13 par.1 dhe 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative nr. 03/L-202, dhe rruga e ndjekur nga paditësit për realizimin e të drejtave nga Kontrata e Përgjithshme Kolektive, sipas nenit 2, 52 dhe 54 të Kontratës së Përgjithshme Kolektive të vitit 2015, në shqyrtim dhe trajtim të këtyre kërkesave hyn në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kuptim të nenit 12 par.1 të Ligjit për Gjykatat nr. 06/L-054, e në lidhje me nenin 17, par.1, si dhe nenit 19 dhe 392, pika b) të LPK-së, andaj e njëjta edhe duhet ti shqyrtoj dhe vendos lidhur me kërkesat e paditësve në këtë çështje juridike.

Në ri procedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë, që të lëshohet në procedurën e trajtimit të kërkesave të paditësve, të paditurës t'ia dërgoj aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, së bashku me paditë dhe shkresat tjera të lëndës, në mënyrë që e njëjta brenda afatit ligjor të ketë mundësinë e ushtrimit të përgjigjes në paditë e paditësve, dhe pas kësaj varësisht nga vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë, në vlerësimin se janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrje të aktgjykimeve jashtë seancës gjyqësore nga neni 152 dhe 398 i LPK-së, të nxjerr njërin nga këto aktgjykime vetëm nëse janë plotësuar kushtet e kërkuara ligjore për nxjerrjen e këtij aktgjykimi, dhe nëse konstaton të kundërtën, të caktoj seancë gjyqësore, të vërtetoj të gjitha faktet vendimtare që rezultojnë në pretendimet e palës paditëse dhe prapësimet eventuale të parashtruara nga pala e paditur, dhe me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje juridike, duke përfshirë edhe vendosjen lidhur me shpenzimet e krijuara procedurale varësisht nga suksesi i arritur i palëve në këtë çështje juridike.

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e arsyeve të lartpërmendura, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209, pika (d) të LPK-së, gjeti se duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.2757/22, me datë 26.03.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Besnik Feka